



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjilan me datë: 29.01.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.01.2019, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik **“El-Bau” Sh.p.k & N.N.T “Eing Com” & “Ve-More” sh.p.k** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjobëruese” me Nr. të Prok: GI 651-18-045-2-1-1** nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik **“El-Bau” Sh.p.k & N.N.T “Eing Com” & “Ve-More” sh.p.k** e dt. **28.01.2019** lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjobëruese” me Nr. të Prok: GI 651-18-045-2-1-1** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK për dhënie të kontratës, i datës **22.01.2019** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas vendimit të dt. 22.01.2019.**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

### A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve Ekonomik **“El-Bau” Sh.p.k & N.N.T “Eing Com” & “Ve-More” sh.p.k** me datë 28.01.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjobëruese” me Nr. të Prok: GI 651-18-045-2-1-1**. Autoriteti Kontraktues me datën **29.01.2019** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:  
Pretendimet e juaja ankimore nuk qëndrojnë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Gjilanit gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka konstatuar **se ofertës tuaj i mungon marrëveshja me Plasteline Vemor lidhur me shfrytëzimin e disa makinerive** andaj edhe është eliminuar.

**Andaj, duke u bazuar në të gjitha dëshmitë që posedon AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet ankimore.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv .

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, palët e interesuara mund të paraqesin ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

---

**Izet Kurteshi**

**U.D. Menaxher i Prokurimit**

---

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës.